



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Kryetarja e Komunës

01nr 400-23653

Dt: 29.04.2016

Kryetarja e Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 11, 13 dhe 58. a dhe b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03L-040, nenit 8,9 dhe 10 të Rregullores për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Komunale, Përfundimit 01 Nr. 06-20027-8/1, të miratuar në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve të dt: 15.04.2016 si dhe në harmoni me rekomandimin e Komisionit për ndarjen e subvencioneve të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, për mbështetje financiare të Klubit të Atletikës “Vllaznimi” nga Gjakova, me dt: 29.04.2016 e miraton këtë:

### V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e Klubit të Atletikës “Vllaznimi” nga Gjakova nr. 10-400-18348 e dt: 07.04.2016, për subvencionimin e një pjese të shpenzimeve për pjesëmarrje në kampionatin e Kosovës në Atletikë, duke e mbështetur këtë kërkesë me subvencione komunale në vlerë prej 500€.
2. Autorizohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që të realizon procedurën e zotimit të mjeteve financiare në vlerë prej 500€, nga mjetet e fondit të subvencioneve të Drejtorisë për Kulturë , Rini dhe Sport dhe bartjen e tyre në konton e Klubit të Atletikës “Vllaznimi” nga Gjakova nr. 17-04-001600064631 NLB Bank.

### A R S Y E T I M

Kërkesa e Klubit të Atletikës “Vllaznimi” nga Gjakova e evidentuar nr. 10-400-18348 e dt: 07.04.2016, e prezantuar nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport është në përputhshmëri me rekomandimet e Komisionit për ndarjen e subvencioneve të DKRA për mbulimin e shpenzimeve të ndërlidhura me aktivitetet për pjesëmarrje në kampionatin e Kosovës në Atletikë, duke i ndarë nga kategoria e subvencioneve shumë prej 500€. Pas rekomandimit të Komisionit për ndarjen e subvencioneve të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe shqyrtimin në Mbledhjen e Bordit të dt. 15.04.2016 këtë kërkesë e ka përkrahur edhe Kryetarja e Komunës duke e autorizuar Drejtorinë për Buxhet dhe Financa që të realizon procesin e zotimit e këtyre mjeteve financiare në vlerë prej 500€.

Në bazë të theksimeve të përshkruara më lartë, u vendos si në dispozitiv

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë .

CO: - Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport  
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa  
- Klubit të Atletikës “Vllaznimi” nga Gjakova  
- Arkivi

Kryetarja e Komunës  
Znj. Mimoza Kusari-Lila